

V E N D I M

i Asamblesë së shoqërisë Albanian Tourism and Logistics (ATL) shpk

Për pranimin si përfitues të transferimit pjesor të veprimtarisë ekonomike nga shoqëria Albanian Stevedoring Company (ASC) shpk

Sot më datë 27 Shtator 2023, në selinë e shoqërisë ATL në adresën Rruga Skenderbej, Kati III, ZK 8514, Nr. Pasurie: 4/208/ND-N3, Durrës, u bë mbledhja e Asamblesë së shoqërisë, me rend dite:

Diskutimi dhe marrja e vendimit për pranimin si përfitues i transferimit pjesor, pa pagese, të veprimtarisë ekonomike nga shoqëria Albanian Stevedoring Company (ASC) shpk.

Jane te pranishem ortaket e shoqërisë, z. Luis Hoxha dhe Lorin Hoxha, te cilët zoterojnë nga një kuote të kapitalit të shoqërisë, me nga 50% secili.

Z. Luis Hoxha që është njëkohësisht edhe administrator i shoqërisë paraqet mundësinë e pranimit si përfitues të transferimit pjesor të veprimtarisë ekonomike nga shoqëria Albanian Stevedoring Company (ASC) shpk. Pas diskutimeve, mbështetur në ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar, neni 81, në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 16 dhe në Udhëzimin e ministrit të Financave nr. 6, date 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, neni 21, Asambleja e Shoqërisë.

V E N D O S I:

1. Të pranohet si Marrës i Transferimit, pa pagesë, transferimin pjesor të veprimtarisë ekonomike me objekt “Ngarkim,shkarkim te mjeteve lundruese dhe aktiviteteteve te ngjashme sic jane depozitimi, magazinimi, grupimi, marrjadhe dorezimi i ngarkesave etj”, prej Transferuesit, shoqërisë Albanian Stevedoring Company (ASC) shpk, regjistruar ne QKB me date 28/09/2009, NIPT K92128501U, me seli në adresën: Lagjja 1, Rruga Tregtare, Porti Detar,.Zones se Mirembajtjes Mekanike, Durrës.
2. Elementet konkrete te veprimtarise qe do te pranohen nga transferimi te percaktohen ne Akt Marreveshjen e Transferimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe administratori i shoqërisë autorizohet ta paraqesë atë pranë cdo autoriteti shtetëror të interesuar.

Asambleja e Shoqërisë Albanian Tourism Logistics (ATL) shpk

Luis HOXHA

Lorin HOXHA

